



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 333, datë 4.5.2016

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr.418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas ndarjes "Ministria e Zhvillimit Urban", shtohet ndarja "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", me përcaktimet e paraqitura në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.
3. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

ARBEN AHMETAJ

Tabela

Institucioni Buxhetor	Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (Lekë)	Shpërblim anëtarë (Lekë)
			Kryetari	Nr. i Anëtareve		
Agjencia e Ofrit të Shërbimeve Publike të Integruara	Këshilli Drejtues	8	1	6	20.000	20.000

NR.PROT.2695/1
DATË 3.5.2016

MINISTRISË SË FINANCAVE
A.D.I.S.A.
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

